



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



05/ Nr. / 1413 / 2019

Në bazë të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me Nr. 01/ 4805/ 2018 të datës 30.08.2018 dhe Vendimin për ndarjene mjeteve financiar për bursa për student dhe caktimin e prioriteteve për kuadro deficitare në Kuvendin e Komunës Nr.01/261/2019 të datës 31.01.2019, Drejtoria Komunale për Arsimit, Kulturë Rini dhe Sport bënë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM (KONKURS)

PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTËT NË KOMUNËN HANI I ELEZIT

Kushtet për aplikim:

Të drejtë për të aplikuar për bursë kanë të gjithë studentët të cilët plotësojnë këto kushte;

- a) Të jenë banorë rezidentë të Komunës së Hani të Elezit,
- b) Të jenë student-e të rregullt, por jo me vet financim,
- c) Të kenë regjistruar vitin,
- d) Studenti-ja nëse një herë ka përsëritur vitin, **humbë të drejtën e bursës (vlenë për gjitha vitet),**
- e) Të jenë student-e të Universitetit Publik të Kosovës,
- f) Studenti-ja i cili ka qenë përfitues i bursës në një fakultet, nuk mund të jetë përfitues i bursës për fakultetin e dytë,
- g) Studenti-ja nëse e ka një fakultet të përfunduar, nuk ka të drejt aplikimi për bursë,

Dokumentet e nevojshme për konkurim:

- a) Çertifikata e provimeve (**me vulë origjinale**),
- b) Vërtetimi i semestrit (**me vulë origjinale**),
- c) Fotokopje ID apo indeksin (fotografën, semestrat dhe notat),
- d) Deklarata e bashkësisë familjare,
- e) Çertifikatën e vendbanimit,
- f) Dëshmia se është: invalid i luftës, fëmijë i dëshmorit, veteranit të luftës, martirit të luftës, person me aftësi të kufizuara, familja në skemën sociale, nuk i ka dy prindër, dy dhe një prindër të hendikepuar, i të burgosurit politikë, me gjendje të rënd ekonomike, nuk e ka njërin prind, dëshmi (vërtetim) për punë vullnetare (dy vitet e fundit), për të gjitha këto të cekura më lartë duhet të sjellin dëshminë nga shoqatat dhe institucionet përkatëse (**me vulë origjinale**),
- g) Diplomat, mirënjohjet, çertifikatat për suksesin e arritur në gara-konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare në lëmin e arsimit(dy vitet e fundit),
- h) Studentët e vitit të parë u merret nota mesatare e suksesit të shkollës së mesme të lartë numri i pikëve të testit të arritshmërisë dhe provimet e dhëna në fakultetin përkatës,
- i) Kopjen e letërnjoftimit dhe
- j) Vërtetim mbi llogarinë bankare (origjinale)

Sqarim shtesë: Për bursë kanë **prioritet studentet e vitit të dytë e më lartë**, në rast se nuk plotësohet numri i studentëve që plotësojnë kriteret sipas rregullores do të plotësohet me studentët e vitit të parë sipas **Nenit 15 pika 15.1.9.**

Vërejtje: Nëse në dosjen e aplikuesit mungon një dokument apo nuk përputhen të dhënat e kërkuara sipas kriterëve të konkursit, aplikacioni nuk do të shqyrtohet nga ana e komisionit.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet në **Qendrën për Shërbim të Qytetarëve** të Komunës.

Afati për aplikim është **15 ditë** kalendarike nga dita e publikimit (fillon **20/02/2019**, mbaron **06/03/2019**).

Hani i Elezit

Data: 20.02.2019



Drejtoria e DKA-s
Menduh Vlasi